



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201801142/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda:** *Rekomandojmë marrjen e masave për dhënien e kompensimit financiar për shpenzimet e energjisë elektrike shtetas Sh.M që nga lindja e së drejtës për këtë përfitim, muaji Janar 2018.*

**Drejtuar:** **Znj. Violeta KIKA**  
**Administratore**  
**Njësia Administrative Nr.5**

**TIRANË**

*E nderuar zonja KIKA,*

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 14.06.2018, ka paraqitur ankesë shtetasja Sh.M, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e së drejtës për të përfituar kompensimin financiar për shpenzimet e energjisë elektrike.

Ankuesja shprehet se pasi ka përfituar ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6 %, që nga muaji Janar 2018 e në vijimësi, nuk i është dhënë e drejta e përfitimit të kompensimit të energjisë elektrike. Duke e konsideruar çështjen e saj si shkelje të drejtave ligjore, ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Me marrjen në shqyrtim të ankesës, kemi kryer një korrespondence dhe me shkresën tuaj nr. 1790/1 datë 27.06.2018 na keni kthyer përgjigjen e mëposhtme:

*“..Znj. Sh. M, si rezultat i refuzimit nga sistemi i pikëzimit, trajtohet në vazhdimësi nga fondi 6% i ndihmës ekonomike. Bashkia Tiranë për familjet që trajtohen nga fondi 6% çel vetëm fond për trajtim me ndihmë të këtyre familjeve, deri tani nuk është çelur asnjë fond për kompensim të energjisë elektrike të familjeve që trajtohen nga fondi 6%.*

*Meqënëse kjo familje është përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike në bazë të Udhëzimit nr.1 datë 02.02.2015 “Mbi zbatimin e Vendimit nr.8 datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike, pika 1, këtë kompensim mund ta përfitojnë vetëm familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike”.*

Pas marrjes së kësaj përgjigje, duke gjykuar se e drejta e përfitimit të kompensimit financiar të shpenzimeve të energjisë elektrike, është një e drejtë që u jepet të gjithë kategorisë së personave që janë në skemën e ndihmës ekonomike, pavarësisht se janë përfitues nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6 %, iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në përgjigje të kërkesës sonë, ajo ministri na informon se :

*“...Bazuar në Udhëzimin nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind’, të ndryshuar, familjet që trajtohen nga ky fond konsiderohen familje që përfitojnë ndihmë ekonomike.*

*- Në pikën 1 dhe 3 të Udhëzimit, përcaktohet që ky fond është 6% i bllok-ndihmës ekonomike, pra që përfshin totalin e fondit të ndihmës ekonomike dhe i shtohet çeljes faktike të çdo 2 mujori që transferohet për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit.*

*-Po ashtu në pikën 3 të Udhëzimit përcaktohet që bashkia mund të shtojë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor mbi këtë fond.*

*Për sa më sipër, Udhëzimi nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind’, i ndryshuar, Vendimi nr.565 datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike, i ndryshuar dhe Vendimi nr.8 datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj’, nuk pengojnë trajtimin e këtyre familjeve me kompensim të energjisë elektrike”.*

Nga përgjigja e ardhur rezulton se shtetasja Sh.M duhet të përfitojë të drejtën e dhënies së kompensimit financiar të shpenzimeve të energjisë elektrike.

Kjo shtetase është penalizuar nga moszbatimi i drejtë i Udhëzimit nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind’, të ndryshuar.

*-Vendimi nr.8 datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj”, në pikën 1, ka vendosur . “...1. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:*

*a) familjet, që trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, ....”.*

Me qëllim përfitimin e të drejtave të saj ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave për dhënien e kompensimit financiar për shpenzimet e energjisë elektrike shtetases Sh.M, që nga lindja e së drejtës për këtë përfitim, muaji Janar 2018.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se; “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim...”,

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R**

**Ermir KAPEDANI**